



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2178/4 Prot.

Datë 26.09.2023

**V E N D I M**

**Nr. 955/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.09.2023 me

- Objekt:** Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me objekt “Blerje materiale kancelarie për nevoja të Bashkisë Divjakë” me Nr. REF-78667-08-30-2023 me fond limit: 2,024,824.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: Autostrada Tiranë-Durrës, Km. 09, Kashar, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Divjakë.  
Adresa: Lagjja nr.2, Sheshi “Santa Barbara”, Divjakë.
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.08.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me objekt “*Blerje Materiale Kancelarie për nevoja të Bashkisë Divjakë*”, me Nr. REF-78667-08-30-2023 me fond limit: 2,024,824 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.

II.2. Në datën 06.09.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si edhe pranë autoritetit kontraktor, është administruar ankesa e operatorit ekonomik “*Interlogistic*” SHPK me nr. 2178/2023 prot., datë 06.09.2023 dhe me numër ankimi elektronik A/2023/3398, datë 06.09.2023, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi e më konkretisht:

*“[...] Në shtojcën nr. 6 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit" të dokumenteve standarde të tenderit është kërkuar afati i lëvrimit nga ana Juaj si më poshtë:*

*Afatet e lëvrimit: 14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Në lidhje me sa është kërkuar, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, kjo pasi bëhet fjalë për furnizimin me sasi të konsiderueshme të artikujve të cilët importohen nga furnitorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Duke qenë se operatorët ekonomikë për artikujt objekt i kësaj procedure prokurimi duhet të*

marrin furnizimin nga furnitorë të huaj dhe duke marrë në konsideratë kushtet aktuale të shkaktuara globale të shkaktuara nga Pandemia Covid-19 si dhe lufta në Ukrainë, kaosi i shkaktuar lidhur me transportin dhe rritja shumë e madhe e çmimeve të tij, e bëjnë shumë të vështirë që malli të merret nga jashtë shtetit dhe të lëvrohet në adresën tuaj brenda afatit të përcaktuar në DST. Të ndodhur në kushtet e krizës botërore për sa i përket transportit dhe lëvrimin të mallrave, kërkojmë që afati i lëvrimin të jetë minimalisht 30 ditë nga data e lidhjes së kontratës. Theksojmë se kërkesa e AK është në shkelje të Ligjit LPP dhe Nenit 40 të Rregullores të Prokurimit Publik. Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Vendimin nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", kërkojmë që Autoriteti Kontraktor Bashkia Divjakë dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojë kriterin e mësipërm si të pabazuar në ligj dhe në prova".

....Këto specifikime në lidhje me artikujt e lartpërmendur nuk e justifikojnë qëllimin për të cilin janë vendosur, pasi specifikime teknike të tilla nuk garantojnë cilësinë ose standardin e lartë për këtë produkt. Ndër të tjera konstatojmë se specifikimet teknike të artikujve të sipërpërmendur, të përcaktuara nga ana AK janë kufizuese, diskriminuese dhe nuk garantojnë të drejtën e operatorëve ekonomike të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

Theksojmë se për të shmangur një situatë të tillë e cila të bën të mendosh se AK mund të adresojë në një markë të caktuar apo po kufizon konkurrencën, duhet të parashikoni specifikime për artikujt e mësipërm me një rang më të madh të parametrave duke përcaktuar një marzh me të gjerë specifikimesh e cila krijon mundësinë e ofertimit të artikujve të ndryshëm por gjithmonë cilësore nga operatorë ekonomikë të interesuar për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi.

...

Sa më sipër përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve për artikullin nr. 4 "Bllok shënimesh A5 (kapaku i veshur me lëkurë)" na detyron që të kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës të ndryshohen specifikimet teknike pasi Kapaku i veshur me lëkurë nuk ndikon në funksionalitetin e produktit. Gjithashtu kërkojmë të vendoset një specifikim shtesë "me kapak imitim lëkure" duke qenë se kanë dhe kosto më të lirë.

Në lidhje me artikullin nr. 52 "Dosje kartoni llastik plastik 1cm", artikullin nr. 53 "Dosje kartoni llastik plastik 2.5 CM", artikullin nr. 54 "Dosje kartoni llastik plastik 5cm" si dhe artikullin nr. 53 "Dosje kartoni llastik plastik kuti mesatare 10cm" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikohet artikulli i kërkuar nëse kemi të bëjmë me dosje kartoni apo dosje plastike. Gjithashtu për artikullin artikullin nr. 53 "Dosje kartoni llastik plastik kuti mesatare 10 cm kërkojmë që të hiqet termi me kuti pasi nuk ka dosje me llastik me kuti, nuk ekziston.

Për artikullin nr. 58 "Dosje me mekanizëm (me 20 qese plastike)" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikohet artikulli i kërkuar pasi dosjet me mekanizëm nuk kanë qese plastike. Te përcaktohet sakte përshkrimi i artikullit sipas specifikimit teknik ku korrespondon me dosje me mekanizëm të thjeshtë pa zarfe plastike të cilat janë artikull më vete.

Sa më sipër përcaktimi nga autoriteti kontraktor i specifikimeve për artikullin nr. 62 "Qese plastike Dokumente A4 40 micro (100 copë/pako)" kërkojmë nga institucioni që të specifikohet nëse kërkohen 40 micron apo 100 mikron sipas specifikimeve teknike pasi kanë kosto të ndryshme.

*Në lidhje me artikullin nr. 72 "Shina plastike (3, 6, 8 mm) (100\*3)", referuar specifikimit teknik, kapëset dore 24/6 zakonisht kapin deri në 30 flete. Mbi 30 flete janë kapëse 24/6 me mbajtëse për ne tavoline.*

*Ndërsa për artikullin nr. 94 "Fleta dizanjo" si dhe artikullin nr. 100 "Ngjites letre për afishime" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që për artikullin nr. 94 të specifikohet artikulli në fjale pasi është i paqarte, nëse kërkohej fletore vizatimi ose të vendoset në dispozicion një foto e artikullit. Ndërsa për artikullin nr. 100 të specifikohet artikulli pasi nuk është i qarte, si dhe të vendoset në dispozicion një foto e artikullit.*

*Gjithashtu referuar procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, gjykojmë se autoriteti kontraktor në asnjë rast nuk ka argumentuar teknikisht se si ndikojnë specifikimet teknike të atakuara nga ana jonë, në funksionalitetin e artikujve dhe çfarë pasojash sjell në përdorimin e këtij artikujve modifikimi i këtyre specifikimeve. Në këtë kuadër, pasi evidentuam gjithë bazën ligjore që është shkelur nga ana e Autoritetit Kontraktor në hartimin e këtyre specifikimeve lidhur me artikullin e lartpërmendur, pretendojmë, se autoriteti kontraktor duhet të pranojë pretendimet e sipërcekura në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.*

*... Për të gjitha sa u parashtruan më sipër, në zbatim dhe përrputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik"; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285 date 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, vendimi i KPP-së Nr. 200/2022, datë 25.02.2022, vendimi i KPP-së Nr. 675/2023, datë 26.07.2023, si dhe Direktiva nr. 24/2014 "Për prokurimin publik" Këshillit të Europës, kërkojmë që Autoriteti Kontraktor, Bashkia Divjakë dhe Komisioni i Prokurimit Publik, të ndryshojnë specifikimet e artikujve të sipërpërmendur si të pabazuara në ligj dhe në prova në mënyrë që të rrisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë [...].*

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimesit.

II.4. Me qëllim shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimes, me anë të shkresës nr. 2178/2 prot., datë 15.09.2023, Komisioni i Prokurimit Publik, i ka kërkuar autoritetit kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, ku të pasqyrohet procesi i hartimit dhe miratimit të dokumenteve standarde të tenderit, procesi i hartimit dhe miratimit të kriterëve të veçanta për kualifikim, si dhe vendimin e autoritetit tuaj lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik "Interlogistic" SHPK.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 5006/1 prot., datë 19.09.2023, protokolluar me tonën me nr.2178/3 prot., datë 22.09.2023, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.6. Referuar informacionit të mësipërm rezulton, se ky i fundit nuk e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimes "Interlogistic" SHPK me argumentin se nuk është paraqitur asnjë ankesë brenda afateve ligjore e për rrjedhojë autoriteti kontraktor ka vijuar me hapjen e

ofertave në datën 11.09.2023, ku në mungesë të ofertave të dorëzuara ka vijuar me anulimin e procedurës së prokurimit, anulim i cili është publikuar në buletin nr.78 datë 18.09.2023. Më konkretisht informacioni i autoritetit kontraktor: “[...] Autoritetit Kontraktor ka vazhduar me hapat e mëtejshëm për zhvillimin e procedurës pasi ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ankesë në Autoritetin tonë kontraktor brenda afatit të parashikuar për ankesat në përputhje me nenin 110, pika 1, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik". Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave më datë 11.09.2023 ora 10:00, kanë hyrë në faqet e tyre të punës dhe konstatuan se ishin dorëzuar 0 (zero) oferta nga operatorët ekonomikë, pra nuk ishte dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme. Në këto kushte, bazuar në Nenin 98, pika 1 gërma b dhe Nenin 99 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si edhe në Nenin 38 dhe Nenin 84 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ka propozuar me anë të një Raporti Përmbledhës, Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, të miratojë procedurat e shqyrtimit, si edhe shpalljen e njoftimit të anulimit për procedurën e prokurimit me objekt: "Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë", për të filluar një procedurë të re tenderimi, për arsye të numrit të pamjaftueshëm të ofertave, pra nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme. Ju bëjmë me dije se në datë 13.09.2023," është hedhur në sistemin e prokurimit elektronik formulari i njoftimit të anulimit i procedurës së prokurimit me objekt: "Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë. Bashkangjitur po ju dërgojmë një kopje të procesverbalit për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim dhe një kopje të formularit të njoftimit të anulimit.”

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

### **Arsyeton:**

III.I. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, vlen të theksojmë, se për sa i përket pretendimit të autoritetit kontraktor të paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik ku informon se: “[...] Autoritetit Kontraktor ka vazhduar me hapat e mëtejshëm për zhvillimin e procedurës pasi ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ankesë në Autoritetin tonë kontraktor brenda afatit të parashikuar për ankesat në përputhje me nenin 110, pika 1, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" [...]” sqarojmë, se operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK ka paraqitur ankim në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit, si pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave.

Sa më sipër, vlen të theksojmë, se që në datën 27.10.2021, Komisioni i Prokurimit Publik ka implementuar sistemin e Regjistrimit Elektronik të Ankesave, duke mundësuar tashmë për të gjithë operatorët ekonomikë paraqitjen e ankesës në të njëjtën kohë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, në rrugë elektronike. Me dorëzimin e ankesës në sistemin elektronik, në përputhje me afatet në ligjin 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ankesa menjëherë konsiderohet e dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, njëkohësisht në të dyja institucionet. Ankesa dhe e gjithë përmbajtja e saj është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor, në Sistemin Elektronik të Ankesave.

Në këtë kuadër, nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, është kryer një cikël trajnimesh falas, në 12 qarqe të Shqipërisë, ku janë ftuar të marrin pjesë të gjitha institucionet të cilat zhvillojnë procedura prokurimi, si dhe operatorë ekonomikë, të cilët janë njohur mbi mënyrën e funksionimit dhe përdorimit të këtij sistemi. Akoma më tej, me datë 20.06.2023 Komisioni i Prokurimit Publik, përmes komunikimit elektronik zyrtar, e ka njoftuar autoritetin kontraktor për paraqitjen e ankesës së sipërpërmendur pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për kryerjen e disa veprimeve procedurale në sistemin elektronik të ankesave me qëllim zbatimin e procedurave ligjore.

Sa më sipër, operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK ka paraqitur ankim në rrugë elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, sipas të gjitha kushteve formale dhe afateve të parashikuara ligjore, në lidhje me procedurën objekt-shqyrtimi.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK se: *“Afatet e lëvrimit: 14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës. Në lidhje me sa është kërkuar, pretendojmë se ky afat është tepër i shkurtër, KPP vëren se;*

III.2.1. Në shtojcën 6 “Formulari i sasisë dhe grafiku i lëvrimit” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi përcaktohet si më poshtë:

***Afatet e lëvrimit: 14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.***

<b><i>Artikulli</i></b>	<b><i>Përshkrimi</i></b>	<b><i>Shuma</i></b>	<b><i>Destinacioni</i></b>
<b><i>1</i></b>	<b><i>“Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”</i></b>	<b><i>2 024 824 (dy milion e njëzetë e katër mijë e tetëqind e njëzetë e katër) lekë pa Tvsh.</i></b>	<b><i>Bashkia Divjakë</i></b>

III.2.2. Në formularin e njoftimit të kontratës pika 2.11 “Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës” është përcaktuar: *“2.11 Kohëzgjatja e kontratës ose afati i zbatimit të kontratës: Kohëzgjatja në 14 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.”*

III.2.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.2.4. Neni 3 Parime të përgjithshme *1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin*

*mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III 2.5. Neni 21 Autoriteti ose enti kontraktor 1. *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

III.2.7. Në rastin konkret, referuar pretendimit të ankimesit, si dhe argumenteve të autoritetit kontraktor, KPP gjykon, se afati i lëvrimit i përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me cilësi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasinë e konsiderueshme të mallit që do të lëvrohet, volumin e kontratës dhe shpërndarjes së mallit. Ndaj KPP gjykon, se afati i lëvrimit të mallit në rastin konkret duhet të jetë më i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specififikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi. Për rrjedhojë autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e afatit të lëvrimit të mallit, në mënyrë të tillë që të nxisë pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin me sukses të kontratës.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues "Interlogistic" SHPK qëndron.

III.3. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për modifikimin e specififikimit teknik **për artikullin nr. 44** *"Bllok shënimesh A5 (kapaku i veshur me lëkurë)" na detyron që të kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës të ndryshohen specififikimet teknike pasi*

*Kapaku i veshur me lëkurë nuk ndikon ne funksionalitetin e produktit. Gjithashtu, kërkojmë të vendoset një specifikim shtesë "me kapak imitim lëkure" duke qenë se kanë dhe kosto më të lirë", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,*

III.3.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 6 "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit", bashkëlidhur dokumenteve të tenderit, autoriteti kontraktor ka parashikuar:

*Bllok shënimesh A5 (kapaku i veshur me lëkurë) Copë 50*

III.3.2. Referuar Nenit 2 të ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikon shprehimisht se: *Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efizienzën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.3.3. Referuar Nenit 3, "Parime të përgjithshme" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i cili parashikon shprehimisht se:

- 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në 5 mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.*

III.3.4. Neni 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

III.3.5. Referuar Nenit 36 "Specifikimet teknike" i ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik", parashikon shprehimisht se:

- 1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.*



*Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.*

*Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

*a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

*b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;*

*c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;*

*ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".*

*5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.*

*6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet*

*ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.*

Gjithashtu, në nenin 4, paragrafi 38, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Në pikën 2 të nenit 40, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*“Për mallrat që do të prokurohen, autoritetet/entet kontraktore parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36, të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara”.*

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 2 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, 2 Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët

dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjitha procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërën nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;

Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

III.3.3. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për procedurën e prokurimit dhe është përgjegjësi e tij të përcaktojë specifikime teknike që janë në funksion të realizimit me sukses të kontratës, duke dhënë informacion të plotë me qëllim që operatorët ekonomikë të kenë informacion të qartë dhe të saktë në lidhje me përgatitjen e ofertave të tyre. Po ashtu KPP gjykon, se në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, njësia e prokurimit, në varësi të fondit limit dhe rëndësisë që ka procedura, përcakton kërkesat për artikujt që kërkon të prokurojë, duke i përshkruar

gjithashtu cilësitë në varësi edhe të funksionit të artikujve të caktuar. Është në të drejtën e AK të kërkojë artikuj cilësorë, por gjithmonë duke studiuar tregun, për të përcaktuar qartë përshkrimet e mallrave të cilat AK i konsideron më të përshtatshëm për punën e tyre. Përcaktimi i detajeve, si termi *lëkurë*, i cili nuk ndikon në funksionalitetin e artikullit, është i tepërt dhe kufizues. Operatori ekonomik ankimes me të drejtë argumenton, *që të vendoset një specifikim shtesë "me kapak imitim lëkure"*, pasi ai nuk ndikon në funksionalitetin e artikullit nr.44. Në rastin konkret autoriteti kontraktor përveç specifikimit *lëkurë* duhet të shtojë frazën ose ekuivalent.

Sa më sipër, pretendimi i ankimesit qëndron.

III.4.Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik për specifikimet teknike të disa artikujve të procedurës së prokurimit e konkretisht: "... Në lidhje **me artikullin nr. 52** "Dosje kartoni llastik plastik 1cm", **artikullin nr. 53** "Dosje kartoni llastik plastik 2.5 CM", **artikullin nr. 54** "Dosje kartoni llastik plastik 5cm" si dhe **artikullin nr. 53** "Dosje kartoni llastik plastik kuti mesatare 10cm" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikohet artikulli i kërkuar nëse kemi të bëjmë me dosje kartoni apo dosje plastike. Gjithashtu për artikullin nr. 53 "Dosje kartoni llastik plastik kuti mesatare 10 cm kërkojmë që të hiqet termi me kuti pasi nuk ka dosje me llastik me kuti, nuk ekziston. ...**Për artikullin nr. 58** "Dosje me mekanizem (me 20 qese plastike)" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që të specifikohet artikulli i kërkuar pasi dosjet me mekanizem nuk kane qese plastike. Te percaktohet sakte përshkrimi i artikullit sipas specifikimit teknik ku korrespondon me dosje me mekanizëm të thjeshtë pa zarfe plastike të cilat janë artikull më vete... Në lidhje me artikullin nr. 72 "Shina plastike (3, 6, 8 mm) (100\*3)", referuar specifikimit teknik, kapeset dore 24/6 zakonisht kapin deri ne 30 flete. Mbi 30 flete jane kapeset 24/6 me mbajtese per ne tavoline.Ndërsa për **artikullin nr. 94** "Fleta dizanjo" si dhe **artikullin nr. 100** "Ngjites letre per afishime" kërkojmë nga ana e grupit të shqyrtimit të ankesës që për artikullin nr. 94 të specifikohet artikulli në fjale pasi eshte i paqarte, nese kerkohet fletore vizatimi ose te vendoset ne dispozicion nje foto e artikullit. Ndërsa për artikullin nr. 100 të specifikohet artikulli pasi nuk eshte i qarte, si dhe te vendoset ne dispozicion nje foto e artikullit."

III.4.1. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi specifikimet teknike të artikujve në procedurën e mësipërme të prokurimit. Në këtë kuadër, Komisioni gjykon, se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se projekti apo specifikimi teknik është në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi specifikimet për artikujt e sipërpërmendur. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: "Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të 13 tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit. Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do

*të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit” duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues për të gjitha paqartësitë tija, lidhur me kërkesat e tij për sqarim. Ndaj, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të sqarojë operatorin ekonomik ankimues në mënyrë të argumentuar dhe shteruese lidhur me paqartësitë e parashtruara më sipër. Gjithashtu, Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.*

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.5. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues : *për artikullin nr. 62 “Qese plastike Dokumente A4 40 micron (100 copë/pako)” kërkojmë nga institucioni që të specifikohet nëse kërkohen 40 micron apo 100 mikron sipas specifikimeve teknike pasi kanë kosto të ndryshme.*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se në rastin konkret specifikimi i bërë nga autoriteti kontraktor është i qartë dhe nuk paraqet konfuzion, si tek operatorët ekonomikë në përgatitjen dhe dorëzimin e ofertave, ashtu dhe tek Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në momentin që bëhet hapja dhe vlerësimi i procedurës.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.6. Së fundi, rezulton, se me shkresën nr. 5006/1 prot., datë 19.09.2023 me objekt: *“Dërgim informacioni KPP-së”*, protokolluar me tonën nr. 2178/3 prot., datë 22.09.2023, autoriteti kontraktor njofton Komisionin e Prokurimit Publik se: *“... Autoritetit Kontraktor ka vazhduar me hapat e mëtejshëm për zhvillimin e procedurës pasi ka rezultuar se nuk është paraqitur asnjë ankesë në Autoritetin tonë kontraktor brenda afatit të parashikuar për ankesat në përputhje me nenin 110, pika 1, të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave më datë 11.09.2023 ora 10:00, kanë hyrë në faqet e tyre të punës dhe konstatuan se ishin dorëzuar 0 (zero) oferta nga operatorët ekonomikë, pra nuk ishte dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme. Në këto kushte, bazuar në Nenin 98, pika 1 gërma b dhe Nenin 99 të Ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si edhe në Nenin 38 dhe Nenin 84 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, i ka propozuar me anë të një Raporti Përmbledhës, Kryetarit të Autoritetit Kontraktor, të miratojë procedurat e shqyrtimit, si edhe shpalljen e njoftimit të anulimit për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”, për të filluar një procedurë të re tenderimi, për arsye të numrit të pamjaftueshëm të ofertave, pra nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme. Ju bëjmë me dije se në datë 13.09.2023,” është hedhur në sistemin e prokurimit elektronik formulari i njoftimit të anulimit i procedurës së prokurimit me objekt: “Blerje kancelarie për nevojat e Bashkisë Divjakë”*

Pra, AK ka vijuar me hapat e mëtejshëm të procedurës, duke hapur dhe vlerësuar ofertat dhe sipas tij, pas vlerësimit, asnjë nga ofertat e paraqitura nuk rezultoi ofertë e suksesshme, ndaj e ka anuluar procedurën.

Referuar shkresës së mësipërme, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe verifikimeve të kryera në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vijuar më tej me hapjen dhe vlerësimin e ofertave, pa

nxjerrë KPP një vendim për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.

Përmes këtij veprimi, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me nenin 100, pika 1, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se :  
“1. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti/enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, deri në marrjen e një vendimi përfundimtar ose deklarativ nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

Sa më sipër, duke qenë se vendimi i KPP-së konsiderohet i zbatuar vetëm në momentin që KPP-ja lejon autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit, autoriteti kontraktor nuk duhej të vazhdonte me tej procedurën pa një vendim të KPP-së.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Në rastin konkret, autoriteti kontraktor me veprimet e tij, ka kryer shkelje procedurale, duke vazhduar me hapat e mëtejshëm të procedurës pa nxjerrë KPP një vendim që lejon vijimin e saj, ndaj dhe bazuar në nenin 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, i tërheq vëmendjen autoritetit kontraktor në lidhje me këto veprime procedurale.

Gjithashtu, në kushtet kur procedura e prokurimit me objekt: “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-78667-08-30-2023, me objekt “REF-78667-08-30-2023”, me fond limit, 2,024,824.lekë pa TVSH, është zhvilluar nga autoriteti kontraktor në datën 11.09.2023, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që rikthimi i procedurës në sistemin e prokurimeve elektronike nuk është i mundur teknikisht, e vetmja mënyrë për të mbrojtur interesin e ligjshëm të operatorëve ekonomikë ankimues nga njëra anë dhe interesin publik nga ana tjetër është anulimi i procedurës së prokurimit dhe ripublikimi i saj në përputhje me konstatimet e këtij vendimi të Komisionit të Prokurimit Publik.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik

gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Interlogistic” SHPK për modifikim të dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me objekt “Blerje materiale kancelarie për nevoja e Bashkisë Divjakë” me Nr. REF-78667-08-30-2023 me fond limit: 2,024,824.lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 11.09.2023 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Divjakë.
2. Autoriteti kontraktor të vijojë me anulimin e procedurës së prokurimit.
3. Në rast ripublikimi të procedurës së mësipërme të prokurimit, autoriteti kontraktor të paraqesë në KPP kopje të dokumenteve të tenderit ku të pasqyrohet zbatimi i këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Interlogistic” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

